



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 29 korrik 2022**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1543\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 par. 1 nënpar. 1.1 dhe nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 28 par. 1 nënpar. 1.12 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Nenin 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 12/2017 për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Nenin 9 par. 6 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes ;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Taksave të Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) të datës 27.04.2022 për shqyrtim dhe aprovim të Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Rrjetin e OSSH-së,

**në seancën e mbajtur me datë 29 korrik 2022, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **I. APROVOHET - Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH).**

#### **A r s y e t i m**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27.04.2022 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Metodologjia e taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH)** nga KEDS.
- o Metodologjia e taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes, ka për qëllim që të përcaktoj taksat për kyçje në rrjetin e shpërndarjes të aplikuesve të ri dhe taksat për ngritjen e kapacitetit për shfrytëzuesit aktual të rrjetit të shpërndarjes, si dhe të siguroj procedura dhe informata gjithëpërfshirëse për përdoruesit ekzistues dhe përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes, të cilët kërkojnë kyçje të reja ose modifikime të kyçjeve ekzistuese.
- o Metodologjia e taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes, përcakton obligimet e OSSH-së, që



të ofron shërbime të energjisë elektrike, për përdoruesit ekzistues që shfrytëzojnë këto shërbime, si dhe për përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes të cilat kërkojnë kyçje në rrjetin e OSSH-së.

- ZRRE pas vlerësimit të dokumentit ka paraqitur qëndrimet, propozimet dhe ndryshimet e nevojshme rreth këtij dokumenti, ku pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve të palëve, dokumenti është propozuar për shqyrtim dhe aprovim.
  - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të dokumentit ka konsideruar se janë përmbushur kriteret për aprovim të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes s Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH) dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet:

**Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH).**


**Bordi i ZRRE-së**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Izet Rushiti, Anëtar

  
Selman Hoti, Anëtar

  
Lutfie Dervishi, Anëtar

  
Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KEDS
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji